

# NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT<sup>1</sup>

*Në përputhje me nenin 40, paragrafi 2 të “Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (shtator 2021)*

Data: 27.11.2024

I. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”, Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë

II. Titulli i kontratës: “Furnizim me makina dhe material shpenzues për procesimin e parave”

II.1 Numërtimi i prokurimit: BQK 24 038 111

II.2 Pjesët/lotet e procedurës së prokurimit që anulohen:

Pjesa/Lot 1 – “Furnizimi dhe mirëmbajtja e makinave për procesimin e kartëmonedhave me module të lidhjes”, dhe

Pjesa/Lot 2 – “Furnizimi me module të lidhjes/paketimit për makinat BPM – Kisan K6 Strapper”

II.3 Lloji i procedurës: Procedurë e hapur

II.4 Lloji i prokurimit: Furnizim

**II.5 Buxheti për Pjesën/Lot 1: 180,000 euro.**

**II.6 Buxheti për Pjesën/Lot 2: 30,000 euro**

II.7 Numri i tenderëve të pranuar:

II.7.1 Numri i tenderëve të pranuar për Pjesën/Lot 1: 2 (dy):

“Treo Electronics” (përbush kërkesat teknike të tenderit) me çmim të furnizimit të dy makinave 169,800 euro dhe me çmim vjetor të mirëmbajtjes 15,970 euro (mirëmbajtja e obligueshme për 3 vite) dhe

“Coin LLC” (nuk përbush kërkesat teknike të tenderit) me çmim të furnizimit të dy makinave 191,960 euro dhe me çmim vjetor të mirëmbajtjes 4,200 euro (mirëmbajtja e obligueshme për 3 vite)

II.7.2 Numri i tenderëve të pranuar për Lot 2: 0 (zero)

---

<sup>1</sup> Ky njoftim vlenë vetëm për dy pjesët/lotet e para (1 dhe 2) të kësaj procedure. Për pjesët/lotet tjera ka tjetër njoftim

### **III. Anulimi i procedurës së prokurimit:**

**III.1** Data e vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit (dy pjesëve)  
aktivitetit: 25.11.2024

### **IV. Arsyeja e anulimit:**

#### **IV.1** Arsyeja e anulimit te Pjesës/Lot 1:

Tejkalim i buxhetit, çmimi i ofertës e tejkalon buxhetin e paraparë për këtë aktivitet. Për më tepër që pas vlerësimit dhe krahasimit të ofertave BQK ka konstatuar se për këtë pjesë/lot, vetëm njëri tenderues i kishte plotësuar kriteret teknike. Megjithatë, është vlerësuar se çmimi vjetor i mirëmbajtjes së makinave pas periudhës se garancisë ishte tejet i lartë dhe se në mungesë të konkurrencës oferta e tillë do të kishte kosto ekonomikisht të pafavorshme për BQK-në në periudhën afatmesme.

Si rezultat, anulimi i kësaj procedure nga BQK-ja bëhet në përputhje me “Rregullat e Prokurimit në BQK”, respektivisht sipas Nenit 40, paragrafi 2 si dhe me kushtet tjera të këtij tenderi.

#### **IV.2** Arsyeja e anulimit te Lot 2:

Në mungesë të ofertave të pranuar. Për këtë lot, nuk është dorëzuar asnjë ofertë nga operatorët ekonomikë, duke rezultuar në mungesë të konkurrencës dhe pamundësi për të vazhduar me procedurën e prokurimit.

Si rezultat, anulimi i kësaj procedure nga BQK-ja bëhet në përputhje me “Rregullat e Prokurimit në BQK”, respektivisht sipas Nenit 40 si dhe me kushtet tjera të këtij tenderi..

### **V ANKESAT**

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.